



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË NOVOBËRDËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Novobërdës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Novobërdës ((KNB)), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Novobërdës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Regjistri i pasurisë në PVF ishte nënvlerësuar për 11,975€ si rrjedhojë e klasifikimit të pasurive në klasa jo përkatëse në regjistrin kontabël.
- A2 Vlera e detyrimeve kontingjente në PVF ishte nënvlerësuar për 13,029€.
- B1 Komuna gjatë ekzekutimit të buxhetit, kishte realizuar pagesa në vlerë 149,315€ nga kategori ekonomike joadekuatë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Novobërdës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A3 Në 24 raste kanë munguar evidencat për vijueshmërinë në punë.
- A4 Komuna kishte paguar vlerën prej 14,000€ në formë të paradhënies në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik dhe Ligjin e buxhetit.
- A5 Komuna kishte ekzekutuar pagesa në vlerë prej 139,675€ për punëtorët e angazhuar për pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike pa përcaktim të qartë të kompensimit.
- A6 Në tre (3) raste prej 29,957€, janë evidentuar vonesa në realizimin e pagesës përtej afatit ligjor.
- B2 Komuna në tri (3) raste kishte subvencionuar OJQ në mungesë të thirrjeve publike.
- B3 Komuna nuk kishte arritur të bëjë verifikimin e të gjitha pronave komunale.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Novobërdës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Novobërdës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Novobërdës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Novobërdës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Novobërdës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit janë identifikuar fusha të ndryshme që kërkojnë përmirësim në menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Çështjet me ndikim më të madh në opinionin financiar përfshijnë: klasifikimin jo të saktë të shpenzimeve, paraqitjen e pasaktë të detyrimeve kontingjente dhe të pasurive jofinanciare.

Po ashtu, janë evidentuar mangësi në menaxhimin e subvencioneve dhe transfereve, përfshirë mbështetjen financiare për OJQ-të pa përmbushje të plotë të kriterëve të thirrjeve publike. Në kategoritë e mallrave dhe shërbimeve, si dhe në investimet kapitale, janë vërejtur vonesa në pagesat e faturave, mungesë transparence në kompensimin e punëtorëve sezonalë dhe pagesa të realizuara në formë të paradhënieve.

Në fushën e pagave, janë identifikuar raste të kontratave të paazhurnuara, mungesë të evidencës së vijueshmërisë në punë dhe zyrtarë të angazhuar si ushtrues detyre përtej afateve të lejuara ligjshëm.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Në bazë të mostrave të testuara, shuma e pagesave të realizuara nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore për kontratën kolektive dhe pagat jubilarë ishte 35,784€. Prej tyre, borxhi kryesor ishte 19,624€, ndërsa 12,942€ ishin shpenzime të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre dhjetë (10) janë rekomandime të reja, katër (4) rekomandime të përsëritura dhe një (1) rekomandim pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Regjistrimi jo i saktë i pasurive kapitale në regjistrin kontabël**Gjetja**

Sipas nenit 11 paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores MF Nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurisë jo Financiare në Organizatat Buxhetore përcaktohet se "Pasuritë jo financiare kapitale që gjenden në fazën e investimeve në vijim apo në fazën e ndërtimit duhet të regjistrohen në regjistrin kontabël në kategorinë e investimeve në vijim", "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi".

Ndërsa, sipas nenit 6 parashihet që çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël.

Gjatë auditimit të pasurive jo-financiare, janë identifikuar parregullsi dhe pasaktësi në regjistrimin e pasurive kapitale në regjistrin kontabël të Komunës, konkretisht:

- Komuna nuk kishte regjistruar në regjistrat kontabël pagesën në vlerë 14,000€ që ka të bëjë me revitalizimin e objektit për Qendrën e angazhimit të komunitetit në bazë të marrëveshjes me OJQ "Qendra e përfshirjes së grave". Investimet kanë të bëjnë me renovimin e objektit e cila është pronë e Komunës dhe është dashur të regjistrohen në regjistrin kontabël të Komunës. Kjo kishte ndikuar që pasuria të nënvlerësohet për 14,000€;
- Projekti "Asfaltimi i rrugëve në Bolevc - Jasenovik", me vlerë të kontratës prej 47,374€ ishte regjistruar pjesërisht si investim në vijim në vlerë prej 37,374€, ndërsa 10,000€ ishin regjistruar si pasuri në përdorim, mbi të cilën ishte aplikuar një zhvlerësim në vlerë prej 542€. Sipas raportit të pranimi teknik, projekti ka përfunduar me datë 30.11.2023, dhe i gjithë investimi është dashur të klasifikohet si pasuri në përdorim nga kjo datë.

Megjithatë, për shkak të regjistrimit të pjesshëm dhe aplikimit të zhvlerësimit vetëm mbi një pjesë të pasurisë, regjistri kontabël nuk pasqyron gjendjen reale të pasurisë, duke rezultuar në një mbivlerësim neto prej 2,024€; dhe

- Për kontratën "Hartimi i projekteve kapitale për nevojat e Kuvendit Komunal Novobërdë", Komuna kishte realizuar dy pagesa në vlerë totale prej 8,855€, për hartimin e projekteve kryesore për shtatë (7) projekte kapitale. Këto pagesa janë regjistruar në regjistrin kontabël si pasuri në përdorim, konkretisht: pagesa prej 4,855€ me kodin 31690 - pajisje të tjera, dhe pagesa prej 4,000€ me kodin 31250 - kanalizimi. Regjistrimi i këtyre shpenzimeve si pasuri në përdorim është i pasaktë, pasi ato kanë të bëjnë me projektimin e projekteve kapitale të cilat ende nuk kanë përfunduar dhe si të tilla duhej të regjistroheshin si investime në vijim, secila e ndarë sipas projektit kapital për të cilin është hartuar.

Për shkak të regjistrimit si pasuri në përdorim në fund të vitit, nuk është aplikuar zhvlerësimi për këto pasuri, ndërsa zhvlerësimi do të pasqyrohet në vitin vijues.

Parregullsitë e evidentuara janë rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit dhe klasifikimit të pasurive.

Ndikimi

Mangësitë e lartë cekura ndikojnë në mbivlerësimin / nënvlerësimin e gjendjes së pasurisë në pasqyrat financiare vjetore duke mos prezantuar gjendjen e drejtë dhe të saktë të tyre.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të sigurojë që të ndërmerren veprime për përmirësimin e menaxhimit të pasurisë, duke garantuar që regjistrimi dhe klasifikimi i të gjitha pasurive të bëhet në përputhje me gjendjen reale dhe kërkesat ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Parregullsi në raportimin e detyrimeve kontingjente në pasqyrat vjetore financiare (PVF)

Gjetja

Sipas nenit 18 të Rregullores Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, organizatat buxhetore në harmoni me LMFPP-në, raportojnë të gjitha detyrimet kontingjente.

Gjatë auditimit të detyrimeve kontingjente, kemi vërejtur se vlera e raportuar në PVF ishte nënvlerësuar në vlerë prej 13,029€, për shkak të rasteve si në vijim:

- Tri (3) raste, në vlerë totale prej 10,011€, ishin prezantuar në pasqyrat vjetore financiare si detyrime kontingjente, mirëpo zyrtarët komunalë nuk posedonin dosjet përkatëse të lëndëve. Sipas sqarimeve të tyre, këto padi nuk ishin trashëguar nga avokati paraprak gjatë dorëzimit të lëndëve dhe nuk figurojnë në arkivën e Komunës;
- Një (1) rast, në vlerë prej 818€, ishte përmbyllur përmes një urdhri përmbarimor, por megjithatë ishte prezantuar gabimisht si padi ende aktive;
- Një (1) padi, në vlerë prej 2,200€, ishte regjistruar dy herë në pasqyrat financiare, duke shkaktuar mbivlerësim të detyrimeve kontingjente për të njëjtën shumë; dhe
- Dy (2) padi, me vlerë reale prej 5,300€, ishin prezantuar gabimisht si padi në vlerë prej 60,355€. Ky gabim kishte ndodhur për shkak të një lëshimi teknik nga ZKF, i cili gjatë bartjes së të dhënave nga regjistri i zyrës ligjore kishte gabuar në përzgjedhjen e rreshtit. Megjithatë, vlera totale e detyrimeve kontingjente nuk ishte ndikuar.

Mungesa e kontrolleve të brendshme dhe e koordinimit ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Financa, si dhe lëshimet në procesin e ruajtjes dhe menaxhimit të dokumentacionit ligjor, kanë ndikuar në raportim jo të saktë të detyrimeve kontingjente.

- Ndikimi** Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PVF të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherësh ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.
- Rekomandimi A2** Kryetari duhet të forcojë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe të sigurojë bashkëpunim më të mirë ndërmjet Zyrës Ligjore dhe Zyrës për Financa për të siguruar që të gjitha detyrimet kontingjente të raportohen me saktësi dhe të jenë të mbështetura me dokumentacionin përkatës. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime për të siguruar trashëgiminë e plotë të lëndëve juridike gjatë ndërrimit të stafit përgjegjës.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike

- Gjetja** Sipas nenit 18 pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB-të duhet të aplikojnë.
- Në bazë të pagesave të testuara, kemi vërejtur se janë bërë pagesa nga kodet joadekuate në vlerë 149,315€ si në vijim:
- Nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, janë bërë pagesa që i takojnë subvencioneve dhe transfereve në gjashtë (6) raste në vlerë 18,610€; dhe
 - Nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, janë bërë pagesa që i takojnë mallrave dhe shërbimeve, në nëntë (9) raste në vlerë 94,921€. OJQ kishte angazhuar 32 zjarrëfikës me qëllim të kryerjes së shërbimeve për komunën. Pagesat për shërbimet e tilla komuna duhet t'i realizojë përmes shërbimeve kontraktuese tjera dhe të paguhet nga kategoria mallra dhe shërbime.
- Me rastin e ekzekutimit të pagesave nga thesari për obligimet e kontrates kolektive, nga katër (4) mostrat e testuara kemi vërejtur keqklasifikime të shpenzimeve nëpër kategori ekonomike në vlerë prej 35,784€. Nga kjo vlerë, nga mostrat e testuara thesari kishte paguar sipas vendimit përmbartimor të gjykatës për paga jubilarë dhe shujta për arsimtarë nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve 10,979€ dhe nga kategoria e investimeve kapitale 24,805€.
- Klasifikimi joadekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit dhe realizimin e pagesave nga kategoritë adekuate.
- Ndikimi** Pagesat e kryera nga kategoritë joadekuate të shpenzimeve ndikojnë në raportimin financiar jo të drejtë, si dhe në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive të shpenzimeve.
- Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A3 - Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë

Gjetja Sipas nenit 17 pika 1 e Rregullores (QRK) Nr. 04/2024 për orarin e punës, pushimet dhe vijueshmërinë e zyrtarëve publik përcaktohet se “Zyrtari publik është i obliguar që të regjistrohet në regjistrin elektronik të vijueshmërisë”, dhe pika 3 “Kur nuk është e mundur për arsye teknike, vijueshmëria në punë e zyrtarit publik bëhet përmes regjistrimit në librat evidentues”.

Nga 70 mostra të testuara, në 24 raste nuk ishin siguruar evidencat për vijueshmërinë në punë të zyrtarëve komunalë. Prej tyre në një rast në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe dy raste në Administratën Komunale, zyrtarët përkatës kanë deklaruar se nuk janë regjistruar fare në sistem. Ndërkohë, për 21 punonjës të personelit arsimor nuk ishte mbajtur asnjë formë e dokumentimit të pranisë në punë, as përmes sistemit elektronik të regjistrimit, e as përmes librave evidentues.

Kjo ka ndodhur si rezultat i moszbatimit të kërkesave të rregullores për mbajtjen e regjistrit të vijueshmërisë, si rezultat i mungesës së mbikëqyrjes dhe përgjegjshmërisë institucionale.

Ndikimi Mosmbajtja e evidencave për vijueshmërinë në punë rrit rrezikun për pagesa të pabazuara, krijon paqartësi në raport me angazhimin real të zyrtarëve dhe cenon integritetin e procesit të menaxhimit të pagave.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të ndërmarrë masa për të siguruar që në të drejtoritë komunale të mbahen evidenca të vijueshmërisë në punë, në përputhje me kërkesat e rregullores në fuqi. Po ashtu, duhet të forcohet kontrolli dhe përgjegjësia menaxheriale për zbatimin e kësaj kërkeje.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A4 - Kontraktimi dhe pagesa në formë të paradhënies në kundërshtim me Ligjin e prokurimit dhe Ligjin e buxhetit**Gjetja**

Sipas nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, Autoriteti kontraktues mund të përjashtohet nga zbatimi i procedurave dhe dispozitave të ligjit vetëm nëse: zbatimi i tyre do të komprometonte një sekret të ligjshëm ose interesin e sigurisë, dhe nëse Qeveria ka dhënë pëlqimin që kontrata të përjashtohet nga fushëveprimi i ligjit për shkak të kërkesës për masa të veçanta të sigurisë ose klasifikimit të lëndës si sekret shtetëror. Ky përjashtim do të vlejë vetëm në përputhje me Ligjin për qasje në dokumentet publike dhe nuk zbatohet për: trajnime pasuniversitare apo profesionale për punëtorët, shërbime të përfaqësimit për ushqim e pije, kontratat për koncesione që rregullohen me Ligjin për PPP, dhe blerjen apo marrjen me qira të pronave të paluajtshme, përveç rasteve të parashikuara ndryshe me ligj.

Me nenit 13 të Ligjit të Buxhetit Nr. 08/L-260 për vitin 2024, parashihet se OB-të mund të iu paguajnë paradhënie kontraktuesve për projektet kapitale dhe për mallra dhe shërbime deri në pesëmbëdhjetë përqind (15%) të vlerës së kontratës. Pagesa e tillë mund të bëhet vetëm në bazë të kontratës së lidhur në mënyrë ligjore, me vlerë më të lartë se dhjetë mijë euro (10,000 €) e cila është arritur në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik.

Sipas nenit 21 pika 2 të Rregullës financiare Nr. 01/2013 - shpenzimi i parasë publike, Shpenzimet që nuk kërkojnë prokurim janë: pagat, shpenzimet e paguara me para e imët; avancat për udhëtime; komunalit; subvencionet dhe transferet dhe transaksionet ndërdepartamentale. Ndërkaq Neni 23, pika 2 i kësaj rregulle përcakton se raporti i pranimit të mallit/shërbimit nga zyrtari apo komisioni i autorizuar duhet t'i dorëzohet Zyrës për buxhet dhe financa (së bashku me kontratën dhe urdhërblerjen).

Më datë 12.12.2024, Komuna kishte lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me OJQ-në "Qendra e Përfshirjes së Grave" për zbatimin e projektit "Revitalizimi i objektit dhe paisjeve për Qendrën e angazhimit të komunitetit" me afat zbatimi nga 01.12.2024 deri më 30.04.2025, me mundësi zgjatjeje. Projekti kishte për qëllim renovimin e një objekti të papërdorur në fshatin Jasenovik, që është pronë komunale e që do të përdoret si qendër e komunitetit.

Komuna e kishte dhënë objektin në përdorim OJQ-së për realizimin e projektit dhe kishte ekzekutuar pagesën e plotë në vlerë 14,000€ më 23.12.2024 si paradhënie, pa ndonjë dokumentacion mbështetës për punimet e realizuara.

Zbatimi i projektit dhe të gjitha procedurat ishin udhëhequr nga OJQ-ja, ndërsa marrëveshja nuk përmbante asnjë specifikim lidhur me mënyrën e prokurimit të punëve. Sipas raportit financiar të dorëzuar nga OJQ-ja që mbulon periudhën 01.12.2024 - 30.04.2025, ishin raportuar vetëm 10,932€ si shpenzime për realizimin e projektit.

Shkaqet e shmangies së zbatimit të kërkesave ligjore për transferimin e mjeteve, mos kontraktimin dhe mos pranimin e punëve, ishin si pasojë e kontrolleve të dobëta të brendshme. Gjithashtu, marrëveshjet e bashkëpunimit nuk kanë përfshirë specifikime të qarta për të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke lënë hapësirë për paqartësi në mënyrën e zbatimit

dhe verifikimit të shërbimeve të kryera.

Ndikimi

Realizimi i pagesave pa respektuar dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, Ligjit të Buxhetit si dhe procedurave të tjera përkatëse - përfshirë mungesën e raporteve të pranimit të punëve apo shërbimeve - bie ndesh me parimet e transparencës dhe konkurrencës në menaxhimin e fondeve publike. Kjo mundëson anashkalim të mbikëqyrjes dhe përdorim të këtyre fondeve në mënyrë të pa kontrolluar duke rrezikuar arritjen e qëllimit dhe keq menaxhimin e fondeve. Gjithashtu, një praktikë e tillë e transferim të fondeve në kundërshtim me kornizën ligjore të aplikueshme hap mundësi të mëdha të shpenzimit të buxhetit pa realizuar vlerën për para.

Rekomandimi A4

Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimi i fondeve publike të bëhet në përputhje të plotë me legjislacionin e aplikueshëm për menaxhimin e financave publike. Çdo kontraktim i punëve apo shërbimeve duhet të realizohet përmes procedurave të rregullta të prokurimit, ndërsa çdo pagesë duhet të mbështetet në një raport të pranimit të mallrave apo shërbimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A5 - Pagesa ndaj punëtorëve të angazhuar për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike pa përcaktim të qartë të kompensimit

Gjetja

Komuna e Novobërdës më datë 27.02.2024 ka lidhur një kontratë për ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave me Ndërmarrjen Publike Lokale "Ekologjia" D.D. Graçanica, në të cilën janë të specifikuara çmimet për shërbimet e rregullta të mbeturinave. Si vazhdim i kësaj kontrate, më 29.03.2024 është lidhur një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës dhe kësaj Ndërmarrjeje, që ka për qëllim angazhimin e 72 punëtorëve sezonal për një periudhë maksimale prej gjashtë (6) muajsh për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike në këto pozita: tetë (8) punëtorë ndihmës, 14 kopshtarë, 20 punëtorë për sipërfaqe të gjelbëra, 6 mbledhës të mbeturinave, tetë (8) higjienistë, tetë (8) pastrues, gjashtë (6) punëtorë për shërbime funerale dhe dy (2) asistentë.

Sipas nenit 5 të marrëveshjes, NP "Ekologjia" D.D. obligohet të shpallë dhe zbatojë procedurën e pranimit të punëtorëve në bashkëpunim me Komunën, të caktojë mbikëqyrës për procesin dhe t'i dorëzojë Komunës dokumentacionin përkatës të konkursit. Po ashtu, pas përfundimit të procesit të përzgjedhjes, Ndërmarrja duhet të lidhë kontrata me punëtorët e përzgjedhur për periudhën e paraparë. Sipas nenit 6, Komuna obligohet të sigurojë dhe transferojë mjetet financiare për pagesën e pagave.

Gjatë auditimit janë identifikuar gjashtë (6) raste me pagesa në vlerë të përgjithshme prej 139,675€, të kryera nga Komuna ndaj Ndërmarrjes "Ekologjia" për angazhimin e punëtorëve sezonal në mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike. Në marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet palëve nuk është përcaktuar asnjë nivel i kompensimit për secilën pozitë, ishte specifikuar vetëm numri i punëtorëve që do të angazhohen. Si dokument sqarues gjatë auditimit kemi pranuar vetëm dokumentin e konkursit të cilin e kishte shpallur Ndërmarrja, në të cilin janë të listuara pozitat që planifikohej të angazhoheshin, por pa ndonjë specifikim të qartë

për nivelin e pagës për secilën prej tyre.

Sipas sqarimeve të zyrtarëve komunalë, pagesat janë realizuar duke u bazuar në nivelin e pagave të punëtorëve të rregullt të Ndërmarrjes. Megjithatë, kjo mënyrë e përcaktimit të kompensimit nuk është e dokumentuar në marrëveshje.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i hartimit të një marrëveshjeje jo të plotë në aspektin financiar, e cila nuk përmban detaje lidhur me pagat për pozitat e angazhuara. Mungesa e një metodologjie të dokumentuar për përcaktimin e kompensimit dhe mbështetja vetëm në praktikën e brendshme të Ndërmarrjes "Ekologjia" ka ndikuar në krijimin e paqartësive dhe mungesës së transparencës në procesin e pagesave.

Ndikimi

Mungesa e përcaktimit të qartë të kompensimit për secilën pozitë të angazhuar krijon rrezik për keqmenaxhim të fondeve publike, cenon transparencën dhe llogaridhënien, dhe vështirëson mbikëqyrjen efektive të zbatimit të marrëveshjes.

Rekomandimi A5

Komuna duhet të sigurojë që të gjitha marrëveshjet për angazhimin e punëtorëve të përmbajnë specifikime të qarta për nivelin e kompensimit për secilën pozitë. Për më tepër, mënyra e llogaritjes së pagesave duhet të jetë e dokumentuar dhe transparente, në mënyrë që të garantohet menaxhim i drejtë i mjeteve publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A6 - Vonesat në pagesën e faturave

Gjetja

Sipas nenit 39 të LMFPP-së, përcaktohet se ZKF i Organizatës Buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ ose punët e realizuara për OB-në të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim.

Gjatë testimit të mostrave, janë evidentuar tri (3) raste me vlerë të përgjithshme prej 29,957€, në të cilat pagesat nuk janë kryer brenda afatit të përcaktuar me ligj. Konkretisht, vonesat ishin 19 dhe 27 ditë nga data kur pagesat është dashur të kryhen.

Vonesat në pagesa kanë ndodhur si rezultat i mungesës së fondeve për kontratat e lidhura dhe vonesave në kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm.

Ndikimi

Vonesat në pagesën e faturave vështirësojnë realizimin e buxhetit sipas planifikimeve, si dhe mund të shkaktojnë kosto shtesë në buxhetin e Komunës në formë të kamatave dhe procedurave përmbartimore.

Rekomandimi A6

Kryetari duhet të ndërmarrë masa për fuqizimin e kontrollit të brendshëm mbi ekzekutimin e pagesave dhe të sigurojë se të gjitha faturat e vlefshme paguhet brenda afatit prej 30 ditësh.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B2 - Mbështetja financiare për OJQ-të jashtë procedurave të thirrjes publike

Gjetja

Sipas nenit 12.1 të Rregullores MF-Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të organizatave joqeveritare (OJQ), çdo mbështetje financiare për OJQ-të duhet të shpallet me ftesë publike që duhet të publikohet në uebfaqen e ofruesit të mbështetjes financiare.

Gjatë shqyrtimit të procesit të ndarjes së subvencioneve për vitin 2024, është vërejtur se Komuna kishte ofruar mbështetje financiare për tri (3) organizata joqeveritare (OJQ), pa ndjekur procedurën e thirrjes publike, siç kërkohet me Rregulloren Nr. 04/2017 për Ndarjen e Subvencioneve. Mbështetja ishte realizuar përmes marrëveshjeve të mirëkuptimit dhe aneks-memorandumeve, pa vlerësim të hapur të nevojave, kriterëve apo konkurrencës ndërmjet përfituesve potencialë.

Rastet e identifikuara janë:

- Projekti “Mbrojtja nga zjarri” financuar në bazë të një memorandum mirëkuptimi, Komuna kishte realizuar pagesa në vlerë prej 143,545€, të dedikuara kryesisht për pagesën e 32 punonjësve të angazhuar si zjarrfikës nga OJQ “Shoqata e zjarrfikësve vullnetarë”;
- Projekti “Sigurimi i burimeve financiare për një strehimore” - është mbështetur përmes një aneks-memorandumi të datës 27.02.2024, në vazhdim të marrëveshjes bazë të lidhur më 23.05.2017. Pagesat e realizuara janë në vlerë prej 57,741€, të destinuara për kompensimin e 18 punonjësve për OJQ “Qendra e përfshirjes së grave”. Dokumentacioni përmban paqartësi, pasi marrëveshja bazë ishte lidhur me OJQ “Shoqata e grave të kthyera - Shtëpia e jonë”. Sipas sqarimeve të zyrtarëve përkatës të Komunës, fillimisht kishte ekzistuar një OJQ e vetme, e cila më vonë është ndarë në dy OJQ; dhe
- Projekti “Përmirësimi i sigurimeve shoqërore dhe cilësisë së jetës në pleqëri” - është financuar në bazë të një aneks-memorandumi të datës 13.04.2023, të lidhur me marrëveshjen bazë të datës 30.01.2017 për OJQ “Shoqata e grave të kthyera - Shtëpia e jonë”. Gjatë vitit 2024, Komuna ka realizuar pagesa në vlerë 48,580€, të dedikuara për kompensimin e 94 punonjësve të angazhuar në zbatim të projektit. Vlen të theksohet se kryetarja e OJQ-së përfituese është njëkohësisht e punësuar si mësimdhënëse në një shkollë fillore të komunës.

Këto parregullsi kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të dispozitave të Rregullores MF Nr. 04/2017 nga ana e zyrtarëve përgjegjës në Komunë. Mungesa e praktikës për shpalljen e thirrjeve publike dhe mbështetja e vazhdueshme e projekteve përmes marrëveshjeve të mëhershme, pa vlerësim të hapur apo dokumentacion mbështetës të përditësuar, tregon për dobësi në funksionimin e kontrolleve të brendshme dhe në zbatimin e një qasjeje të drejtë dhe të barabartë për të gjitha OJQ-të përfituese potenciale.

Ndikimi Ndarja e subvencioneve pa thirrje publike cenon transparencën, barazinë në qasje dhe konkurrencën ndërmjet organizatave joqeveritare, duke krijuar rrezik për përzgjedhje jo të drejtë të përfituesve dhe rrisin mundësinë për përdorim joefikas të fondeve publike.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar që çdo mbështetje financiare për OJQ-të në të ardhmen të bëhet vetëm pas publikimit të thirrjeve publike, në përputhje të plotë me kërkesat ligjore. Po ashtu, duhet të forcohen kontrollet e brendshme për të parandaluar dhënien e subvencioneve pa procedurë, të kërkohej dokumentacion i plotë dhe zyrtar në rastet e ndarjes ose transformimit të OJQ-ve, dhe të sigurohet që përzgjedhja e përfituesve të bazohet në parime të transparencës, konkurrencës dhe llogaridhënies.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B3 - Mos verifikim i gjendjes aktuale të pronave komunale

Gjetja Sipas nenit 15 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme parashihet që Komuna çdo vit duhet të kryej veprime të inspektimit (verifikimit) për të paktën 20% e të gjitha objekteve brenda territorit të Komunës.

Gjatë auditimit është konstatuar se Drejtorati i Tatimit në pronë nuk ka arritur të përmbushë nivelin minimal të verifikimit të pronave, ashtu siç kërkohej. Nga gjithsej 3,830 prona të regjistruara në territorin e komunës, janë verifikuar vetëm 53 prona, që përfaqësojnë 1.38% të totalit. Kjo përqindje e ulët e verifikimit cenon përditësimin dhe saktësinë e të dhënave në regjistrin e tatimit në pronë, të cilat shërbejnë si bazë për llogaritjen e detyrimeve tatimore.

Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme njerëzore dhe organizimi joefikas i proceseve të verifikimit kanë ndikuar në mosrealizimin e plotë të planit të verifikimit të pronave.

Ndikimi Mos verifikimi i plotë i pronave rezulton me informata jo të plota të pronës së tatueshme aktuale si dhe ndikon në vlerësim jo të saktë të të hyrave për tatimin në pronë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje është 2,728,133€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 367 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 318 me orar të plotë dhe 40 me gjysmë orari.

Çështja A7 - Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik

Gjetja	Sipas nenit 102 pika të Ligjit Nr. 08/L-197 për zyrtarët publik përcaktohet se “Me hyrje në fuqi të këtij ligji, obligohen të gjitha institucionet që të përgatisin dhe t’ju ofrojnë zyrtareve/ëve aktual për nënshkrim aktet e reja të emërimit dhe/apo kontratat e punës”. Nga 70 kontrata të testuara gjatë auditimit, në 51 raste kontratat nuk ishin të azhurnuara në përputhje me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publik. Këto raste përfshijnë: 28 kontrata në sektorin e arsimit, tetë (8) kontrata në sektorin e shëndetësisë, dhe 15 kontrata në administratën komunale. Mos azhurnimi i kontratave ka ardhur si rezultat i neglizhencës së zyrtarëve për azhurnimin e tyre, e cila është një kusht paraprak për zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publik në aspektin e kontratave dhe koeficienteve të ri.
Ndikimi	Mos azhurnimi i kontratave të punës dhe mospërputhja me sistemin e ri të koeficienteve ka shkaktuar mosrespektim të kërkesave ligjore dhe njëherit ndikon në mos përfshirjen e saktë të pozitave në strukturën e pagave.
Rekomandimi A7	Kryetari duhet të sigurojë se të gjitha kontratat e punës për zyrtarët komunal të azhurnohen dhe janë në përputhje me kërkesat e Ligjit për Zyrtarët Publik.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A8 - Mbajtja e pozitave me ushtrues detyre përtej afateve ligjore

Gjetja	Sipas nenit 35, pika 3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik përcaktohet se “Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë”. Gjatë auditimit kemi vërejtur se në gjashtë (6) raste është tejkaluar afati ligjor për ushtrimin e pozitave me ushtrues detyre, ku kohëzgjatja e tejkalimit varion nga një (1) muaj deri në shtatë (7) vjet e nëntë (9) muaj. Prej tyre, pesë (5) raste janë evidentuar në sektorin e Arsimit dhe një (1) në Administratë. Në Drejtorinë e Arsimit, për pozitën e drejtorit të SHFMU “Minatori” janë zhvilluar procedura të rekrutimit, por të njëjtat janë anuluar tri (3) herë për
---------------	--

shkak të mungesës së kandidatëve të interesuar. Ndërkohë, për pozitat tjera të mbuluara me ushtrues detyre nuk janë ndërmarrë fare procedura për shpalljen e konkurseve.

Zgjatja përtej afatit ligjor e ushtrimit të detyrës në pozita drejtuese ka ardhur si rezultat i mosndërmarrjes së masave të mjaftueshme nga menaxhmenti për adresimin e situatës dhe mungesës së angazhimit të duhur për mbulimin e këtyre pozitave.

Ndikimi

Mbajtja e pozitave drejtuese me ushtrues detyre përtej periudhës së përcaktuar me ligj përbën shkelje të dispozitave ligjore dhe rrezikon që këto pozita të udhëhiqen nga persona që nuk i plotësojnë kriteret e nevojshme për atë pozitë.

Rekomandimi A8

Kryetari duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar rekrutimin e rregullt për pozitat që aktualisht mbulohen me ushtrues detyre, në mënyrë që të respektohen afatet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.2 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 415,076€, derisa janë shpenzuar 413,891€ apo 99% të buxhetit. Ato kryesisht kanë të bëjnë me subvencionimin e OJQ-ve.

Çështja A9 - Mos përmbushja e kriterëve sipas thirrjes publike me rastin e përfitimit të subvencioneve

Gjetja

Sipas thirrjes publike të datës 08.05.2023 për subvencionimin e mekanizmave bujqësorë (motokultivatorëve dhe pajisjeve përcjellëse), një nga kriteret thelbësore për aplikim ishte që përfituesi duhet të posedojë një traktor dhe të marrë një mekanizëm përcjellës në bujqësinë e arave dhe frutikulturës. Si dëshmi, kërkohej dokumentacioni i pronësisë së traktorit në emër të aplikuesit.

Në një (1) rast të përfitimit të subvencionit, përkatësisht në kontratën e datës 17.04.2024 me vlerë 710€, është konstatuar se përfituesi nuk i kishte përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në thirrjen publike, pasi dëshmia e pronësisë së traktorit nuk ishte në emrin e tij, siç kërkohej me kriteret e publikuara.

Pas kërkesës sonë për sqarim, Komuna ka ofruar një dëshmi të noterizuar për shfrytëzimin e traktorit, të lëshuar më 13.05.2025, pra pas datës së lidhjes së kontratës, gjë që konfirmon se dokumentacioni i kërkuar nuk ishte i plotësuar në kohën e aplikimit.

Shkaku i kësaj situatë lidhet me mangësitë në procesin e verifikimit të dokumentacionit dhe mungesën e kontrolleve adekuate nga komisioni përgjegjës për vlerësimin e aplikimeve, duke lejuar përzgjedhjen e një përfituesi pa përmbushur kushtet e përcaktuara.

Ndikimi

Përzgjedhja e përfituesve që nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në thirrjen publike cenon parimet e barazisë dhe transparencës, si dhe rrit rrezikun për keqpërdorim të pajisjeve të subvencionuara dhe përdorim joefikas të fondeve publike.

Rekomandimi A9

Kryetari duhet të sigurojë që përzgjedhja e përfituesve të subvencioneve të bëhet vetëm mbi bazën e përmbushjes së plotë të kriterëve të përcaktuara në thirrjen publike, duke përfshirë verifikimin e saktë dhe në kohë të dokumentacionit të kërkuar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokatitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 204,433,138€, pasurive jokatitale është 72,947€, si dhe e stoqeve 646€.

Çështja C1 - Inventarizim jo i plotë i pasurisë dhe mosfunktionalizimi i sistemit E-pasuria

Gjetja

Neni 19 paragrafi 4.3 i rregullores Nr. 02/2013 - për Menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se: Përgjegjësi e Komisionit për Inventarizimin e Pasurive jo Financiare është edhe “Krahasimi i gjendjes të inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare”. Ndërsa, sipas nenit 6, pika 3 të kësaj rregulloreje, pasuritë jokatitale dhe stoqet duhet të regjistrohen dhe menaxhohen nga program e-pasuria.

Pasuritë jokatitale nën 1,000€ dhe stoqet në Komunën e Novobërdës përkundër rekomandimeve të dhëna ende nuk regjistrohen në sistemin e-pasuria, por ato regjistrohen në formatin Excel.

Komuna nuk ka realizuar inventarizimin e plotë të pasurisë për vitin 2024. Ky proces është zhvilluar vetëm në Drejtorinë e Administratës komunale, ndërsa ka munguar në sektorët si: arsimi, kultura, rinia, sporti, shëndetësia dhe mirëqenia sociale.

Kjo kishte ndodhur për shkak të përpjekjeve të pamjaftueshme nga Komuna për funksionalizimin e këtij sistemi. Ndërsa, mos kryerja e inventarizimit të pasurisë në të gjitha drejtoritë përkatëse rezulton me mungesën e përgjegjësisë në kryerjen e detyrave të përcaktuara nga Zyrtari kryesor administrativ.

Ndikimi

Mos funksionimi i sistemit e-pasuria pamundëson menaxhimin dhe kontrollin efektiv të pasurive jo kapitale, përderisa mbajtja e evidencave manuale për pasuritë rrezikon në mundësinë e gabimeve në këto regjistra. Mos kryerja e inventarizimit në të gjitha drejtoritë përkatëse, rezulton me mangësi në informatat e plota lidhur me pasuritë.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të ndërmarrë masa konkrete për të siguruar funksionalizimin e plotë të sistemit e-Pasuria dhe përdorimin e tij nga të gjitha drejtoritë komunale për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive jokatitale dhe stoqeve. Po ashtu, duhet të sigurojë që procesi i inventarizimit të zhvillohet në të gjitha njësitë organizative, në mënyrë që gjendja reale e pasurisë të reflektohet me saktësi në pasqyrat financiare vjetore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna e Novobërdës në PFV-të e vitit 2024 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,119,215€. Kjo vlerë përbëhet prej tatimit në pronë në vlerë 1,009,774€, të hyrave nga qiraja prej 45,441€ dhe taksës për ushtrimin e veprimtarisë prej 64,000€. Gjatë vitit 2024, llogaritë e arkëtueshme nga tatimi në pronë janë rritur për 286,760€ ose 39% krahasuar me vitin 2023.

Çështja B4 - Mosndërmarrja e veprimeve për arkëtimin e borxheve

Gjetja

Sipas nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme përcaktohet se Ministria e Financave dhe organet kompetente përmbaruese kanë autoritetin dhe kompetencat për të mbledhur detyrimet tatimore që kalojnë shumë 10€.

Në nenin 27 përcaktohet se nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori.

Gjatë vitit 2024, vlera totale e borxheve të arkëtueshme të Komunës ka arritur në 1,119,215€, nga të cilat 1,009,774€ (90%) lidhen me tatimin në pronë.

Edhe pse komuna ka ndërmarrë veprime duke dërguar njoftime për borxhlinjtë me detyrime mbi 300€, nuk janë ndërmarrë masa të tjera konkrete ligjore për inkasimin e këtyre borxheve.

Mungesa e veprimeve konkrete ka rezultuar nga mosangazhimi i vazhdueshëm i njësive përgjegjëse për arkëtimin e të hyrave, si dhe mungesës së një plani të koordinuar për trajtimin e borxheve të pambledhura.

Ndikimi

Mosinkasimi i borxheve të akumuluar ndikon drejtpërdrejt në rënie të nivelit të të hyrave vetanake, duke kufizuar kapacitetin financiar të komunës për realizimin e objektivave të saj zhvillimore dhe projekte kapitale që varen nga fondet vetanake.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.5 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në Komunë të Novobërdës operon me vetëm Drejtorin e NjAB-së. Për vitin 2024 kjo njësi kishte hartuar planin vjetor të punës bazuar në planin strategjik ku kishte planifikuar gjashtë (6) auditime të rregullta, prej të cilave ishin finalizuar pesë (5) nga auditimet e planifikuara në Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, Drejtorinë e Bujqësisë, Drejtorinë e Urbanizmit dhe Kadastrit, Drejtorinë për Buxhet dhe Financa si dhe auditimin për procedurat e prokurimit. Po ashtu kishte përfunduar edhe një raport jashtë planit për vijueshmërinë në punë. Në këto raporte janë dhënë gjithsej 18 rekomandime. Prej tyre 13 ishin zbatuar, 3 ishin në proces dhe 2 të pazbatuara. Periudha e mbuluar në raportet e NjAB kryesisht përfshinte vitin 2024.

Çështja A10 - Mungesa e Komitetit të auditimit dhe e planeve të veprimit për zbatimin e rekomandimeve

Gjetja

Sipas nenit 4 të Udhëzimit Administrativ MF Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektet e sektorit publik, “çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB) në nivel të organit kryesor, është i obliguar të themelojë Komitetin e Auditimit.”

Po ashtu, neni 9 pika 7 i Rregullores QRK Nr. 01/2019 për funksionimin e auditimit të brendshëm përcakton se auditorët e brendshëm duhet të monitorojnë në mënyrë sistematike zbatimin e rekomandimeve, bazuar në një plan veprimi të miratuar nga udhëheqësi i institucionit.

Komuna nuk e ka themeluar Komitetin e Auditimit, ndonëse kjo kërkohet me bazë ligjore. Për më tepër, në gjashtë (6) raporte të auditimit të brendshëm është konstatuar se menaxhmenti dhe drejtoritë përkatëse nuk kanë hartuar plane të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së. Si pasojë, NjAB nuk ka pasur në dispozicion një mekanizëm të strukturuar dhe të dokumentuar për monitorimin dhe ndjekjen sistematike të progresit në zbatimin e rekomandimeve të saj.

Mangësitë e evidentuara janë rezultat i mungesës së përkushtimit nga ana e menaxhmentit komunal për të respektuar kërkesat ligjore që rregullojnë funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Moskrijimi i Komitetit të Auditimit dhe mosndërmarrja e veprimeve për hartimin e planeve të veprimit pasqyrojnë një qasje të dobët institucionale ndaj rolit të auditimit të brendshëm dhe rekomandimeve të tij.

Ndikimi

Mungesa e një strukture funksionale për ndjekjen e rekomandimeve, si dhe mungesa e Komitetit të Auditimit, rrezikojnë integritetin dhe besueshmërinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, e kufizojnë vlerësimin e masave korrigjuese të ndërmarra nga menaxhmenti dhe pamundësojnë marrjen e vendimeve të bazuara në informata për përmirësimin e proceseve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Rekomandimi A10

Kryetari duhet të ndërmarrë masa për themelimin dhe funksionalizimin e Komitetit të Auditimit, në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, duhet të sigurojë që të gjitha drejtoritë përkatëse të hartojnë dhe dorëzojnë plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të NjAB-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁸	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	3,925,194	4,331,267	4,238,629	4,061,733	3,200,636
Grante Qeveritare - Buxheti	3,611,349	3,531,853	3,507,299	3,445,606	2,622,015
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	32,132
Të bartura nga viti i kaluar	0	321,558	290,249	266,477	174,401
Të hyrat vetanake	313,845	417,735	407,584	195,189	200,990
Donacionet vendore	0	57,069	33,496	0	18,922
Donacionet e jashtme	0	3,054	0	154,460	152,175

Buxheti final i Komunës së Novobërdës është më i lartë se buxheti fillestar për 406,073€ apo 10.3%. Kjo rritje e buxhetit është si rezultat i zvogëlimit të buxhetit nga granti qeveritar prej 79,497€, përfshirjes së të hyrave të bartura nga vitet paraprak në vlerë prej 321,558€, të hyrave vetanake prej 103,890€ dhe donacioneve në vlerë prej 60,122€ në buxhet final.

Në vitin 2024, Komuna ka shpenzuar rreth 98% të buxhetit final ose 4,238,629€, me një rritje prej 3% në raport me vitin e kaluar. Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Nga kategori të ndryshme ekonomike, Thesari ka ekzekutuar pagesa në vlerë prej 121,499€ bazuar në vendime përmbarimore/gjyqësore që lidhen me obligime nga kontrata kolektive.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	3,925,194	4,331,267	4,238,629	4,061,733	3,200,636
Pagat dhe mëditjet	2,807,629	2,728,133	2,728,133	2,632,915	2,156,353
Mallrat dhe shërbimet	465,781	690,269	678,988	513,484	336,952
Komunalitë	100,000	110,040	110,006	91,508	83,636
Subvencionet dhe transferet	280,000	415,076	413,891	350,801	260,894
Investimet Kapitale	267,376	383,342	307,611	473,025	362,802
Rezervat	4,408	4,408	0	0	0

Realizimi buxhetor sipas kategorive ekonomike është paraqitur si më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 79,497€. Për periudhën janar - dhjetor 2024, realizimi i buxhetit ishte në shumën 2,728,133€, që përfaqëson 100% të realizimit në raport me buxhetin final;


- Buxheti final për mallra dhe shërbime është rritur për 224,488€ krahasuar me buxhetin fillestar. Ky buxhet përbëhet kryesisht nga: granti qeveritar në vlerë prej 362,781€, të hyrat vetanake në shumën 176,890€, të hyrat e bartura nga viti paraprak prej 150,464€, si dhe donacioneve në vlerë prej 135€. Deri në fund të vitit 2024, realizimi i këtij buxheti ishte 678,988€, që paraqet rreth 98% të realizimit në raport me buxhetin final;

- Buxheti final për komunalitet është rritur për 10,040€. Ky buxhet përbëhet nga granti qeveritar prej 80,000€, të hyrave vetanake prej 30,000€ dhe të hyrave të bartura prej 40€. Deri në fund të vitit 2024, realizimi i këtij buxheti ishte 110,006€ apo rreth 99.9% të buxhetit;

- Buxheti final për subvencione dhe transfere është rritur për 135,076€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar prej 140,000€, të hyrave vetanake prej 160,000€, të hyrave të bartura prej 81,579€ dhe donacioneve prej 33,496€. Deri në fund të vitit 2024, realizimi i këtij buxheti ishte 413,891€ apo 99.7% të buxhetit; dhe

- Buxheti final për investime kapitale ishte rritur për 115,966€. Buxheti final përbëhet nga granti qeveritar në vlerë prej 216,531€, të hyrave vetanake prej 50,845€, të hyrave vetanake të bartura prej 89,475€ dhe donacioneve prej 26,491€. Deri në fund të vitit 2024 Komuna kishte arritur të shpenzojë 307,611€ apo 80.2% të buxhetit. Vlen të theksohet se vlera prej 68,041€ është ekzekutuar përmes vendimeve gjyqësore për kontratë kolektive dhe paga jubilarë nga kategoria e investimeve kapitale.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Novobërdës në 2024 ishin në vlerë 496,983€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, taksat për leje të ndërtimit, participimet, taksat për ndërrimin e destinimit të tokës, etj. Për vitin 2024, Komuna kishte planifikuar të hyra në vlerë prej 313,845€.

Përveç kësaj shume, të hyrat nga gjobat në trafik dhe gjobat nga Gjykatat ishin në shumën 94,041€ të cilat grumbullohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) të cilat i alokohen Komunës për shpenzim. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e më poshtme, për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministrinë e linjës

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	313,845	313,845	496,983	430,478	364,088
Të hyrat tatimore	117,019	117,019	188,639	153,462	133,271
Të hyrat jo tatimore	196,826	196,826	308,344	277,016	230,817

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 të Komunës së Novobërdës ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime kryesore. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, një (1) rekomandim ishte zbatuar; një (1) ishin në proces dhe për katër (4) rekomandime nuk kishte filluar zbatimi ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 3 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.	Rekomandimi nuk ishte implementuar, ngase Komuna as këtë vit nuk kishte arritur të bëjë në plotësi verifikimin e pronës.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme që në të ardhmen, me rastin e ndarjes së subvencioneve, të respektohen plotësisht të gjitha dispozitat e rregullores në fuqi, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me publikimin e shpalljeve publike.	Edhe në vitin 2024 ishin mbështetur financiarisht OJQ pa aplikuar thirrje publike.	Nuk ka filluar zbatimi

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të rishikojë vendimet e marra për këshilltarët dhe të sigurojë respektimin e akteve ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në mënyrë që parregullsitë e tilla të identifikuar të mos përsëriten në të ardhmen.	Komuna kishte ndërmarrë veprime për implementimin e rekomandimit dhe menjëherë pas pranimit të raportit këshilltarëve iu është ndërprerë kontrata.	I zbatuar
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve dhe që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël.	Komuna nuk kishte marrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e pasurisë jo financiare për të sigurojë që pasuritë jo kapitale të regjistrohen në sistemin e-pasurisë. Po ashtu duhet siguruar krahasimi i gjendjes së pasurisë jo financiare sipas raportit të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurisë dhe të reflektohen ndryshimet eventuale në PVF.	Vetëm Drejtoria e Administratës kishte përgatitur raportin e inventarizimit të pasurisë për vitin 2024, ndërsa drejtoritë tjera nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim në këtë drejtim. Për më tepër, edhe për vitin 2024, sistemi elektronik "e-Pasuria" ende nuk ishte funksionalizuar për menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive.	Pjesërisht i zbatuar
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të ndërmarrë masat e nevojshme ligjore për arkëtimin e borxheve nga tatimi në pronë, dhe të forcojë kontrollin e brendshëm për mënjanimin e rritjes së vazhdueshme të tyre.	Rekomandimi nuk ishte zbatuar ngase nuk ishin ndërmarrë veprime konkrete për inkasimin e borxhit.	Nuk ka filluar zbatim

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit



Nora Rashiti Nishefci, Udhëheqëse e ekipit



Kushtrim Leci, Anëtar i ekipit



Ajtene Llapashtica, Anëtare e ekipit



Endrita Gjyrevci, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Keqklasifikimi i shpenzimeve në kategoritë ekonomike	Pagesa për OJQ-në e zjarrfikësve vullnetarë është bërë nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve, pasi bëhet fjalë për sektorin e OJQ-ve, ku ndërkohë kemi pasur thirrje publike dhe kemi vazhduar financimin përmes thirrjes publike. Sa i përket ekzekutimit përmes Thesarit, ne nuk kemi kompetencë të ndikojmë në Thesar gjatë pagesave që rrjedhin nga marrëveshjet kolektive, megjithëse edhe ne konsiderojmë se nëse shpenzimet kanë të bëjnë me paga dhe mëditje, ato duhet të mbulohen në atë kategori, të mos na merren mjete në kategoritë tjera ekonomike për të cilat kemi planifikime të veçanta për vitin fiskal.	Keq klasifikimi i shpenzimeve ka ndikuar në prezantimin jo të drejtë të shpenzimeve në pasqyrat financiare, përfshirë edhe pagesat e bëra përmes vendimeve gjyqësore. Komentet e ofruara nuk e adresojnë faktin pse pagesat janë regjistruar në kategori të joadekuata ekonomike. Prandaj, gjetja mbetet e pandryshuar.
Mungesa e dëshmive për vijueshmërinë në punë	Sa i përket punëtorëve në arsim, stafi mësimor përdor ditarë elektronikë në të cilët nuk kemi qasje, pasi shkollat funksionojnë sipas kurrikulës së Republikës së Serbisë. Në Kosovë nuk ekzistojnë ditarë në gjuhën serbe, prandaj përdorim raportet mujore të drejtorëve të shkollave si dëshmi për praninë e stafit në punë. Për punonjësit e administratës, përveç deklaratës së drejtorit për praninë në punë, ka edhe dëshmi të tjera si: raporte pune, kërkesa, vendime, procesverbale etj. Sistemi elektronik është relativisht i ri dhe këto situata kanë ndodhur për shkak të përshtatjes së punëtorëve me regjistrimin elektronik, i cili do të funksionalizohet plotësisht në periudhën në vijim.	Mungesa e dëshmive për praninë në punë të personelit arsimor nënkupton se nuk ka evidencë të verifikueshme ditore për praninë e tyre në punë. E njëjta vlen edhe për rastet në administratën komunale, dokumentet mbështetëse nuk e zëvendësojnë regjistrimin sistematik të pranisë në punë. Si përgjigje nga drejtori i Arsimit është konfirmuar se për shkak të përdorimit të ditarit elektronik jashtë sistemit të Kosovës, komuna nuk posedon raporte mujore për praninë e mësimdhënësve. Komentet e pranuar përfaqësojnë arsyetime që nuk e ndryshojnë gjendjen faktike të konstatuar - prandaj, gjetja mbetet e pandryshuar.

Kontraktimi dhe pagesa në formë të paradhënies në kundërshtim me Ligjin e prokurimit dhe Ligjin e buxhetit	Sipas marrëveshjes nr. 02/2100 të datës 12.12.2024 me OJQ-në “Zenski Inkluzivni Centar”, projekti është financuar nga Misioni i OKB-së në Kosovë, ndërsa komuna vetëm ka marrë pjesë në projekt. Kjo OJQ ka qenë aplikante në projektin e OKB-së. Mjetet nuk janë paguar nga kodi ekonomik për avanse, por nga pjesëmarrja në projekt. Data e miratimit dhe nënshkrimit të marrëveshjes ishte në fund të vitit fiskal dhe për këtë arsye nuk është realizuar si avans. Prokurimi publik nuk ka qenë i zbatueshëm vetëm për pjesën e financimit të komunës prej 14,000 eurosh, ndërkohë që OJQ-ja “Zenski Inkluzivni Centar” kishte pjesën prej 20,000 dollarësh, pasi do të nënkuptonte që dy kompani të ndryshme të punojnë në të njëjtin projekt, duke rrezikuar financim të dyfishtë për revitalizimin e hapësirave të Qendrës CEC në Novobërdë. Për këtë arsye, tërë procedurën tenderuese e ka kryer OJQ-ja Zenski Inkluzivni Centar, projekti është në zhvillim, kryetari ka formuar trupin mbikëqyrës dhe ka emëruar person përgjegjës për koordinimin e implementimit të projektit, ku në fund të realizimit të dorëzojmë tërë dokumentacionin auditimit.	Sipas rregullores financiare dhe legjislacionit në fuqi, është e përcaktuar qartë se cilat kategori të shpenzimeve mund të përjashtohen nga procedurat e prokurimit. Megjithatë, në rastin konkret, fondet e ndara nga Komuna për këtë projekt janë realizuar nga investimet kapitale, të cilat kërkojnë detyrimisht ekzekutim të pagesave vetëm pas pranimit të mallrave apo shërbimeve dhe bazuar në kontratë të lidhur në mënyrë të rregullt ligjore. Pagesa në vlerë prej 14,000€ është bërë në formë avansi, pa dokumentacion mbështetës për punët e kryera dhe pa ndonjë kontratë të strukturuar që specifikon qartë mënyrën e zbatimit të projektit, procedurat për prokurim, apo ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet palëve. Mungesa e këtyre elementeve cenon parimet e transparencës dhe të llogaridhënies në menaxhimin e fondeve publike. Edhe pse gjatë periudhës së draft-raportit janë paraqitur raporte të realizimit të punimeve, ato i takojnë vitit 2025 dhe nuk mbulojnë momentin kur është kryer pagesa (dhjetor 2024). Si rrjedhojë, gjetja mbetet e pandryshuar.
Mbështetja financiare për OJQ-të jashtë procedurave të thirrjes publike	Financimi i OJQ-së së zjarrfikësve është bërë në bazë të thirrjes publike të shpallur pas rekomandimeve tuaja të vitit 2023. Financimi për OJQ-në ZEC është bërë në bazë të marrëveshjes direkte të vitit 2017, dhe është miratuar vendim të Kuvendit të Komunës mbi financimin, pasi OJQ ZEC është specifike dhe e vetmja me licencë për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje për komunitetin serb në Kosovë, mirëpo në të ardhmen e afërme komuna do të bëjë thirrje publike për të gjitha OJQ-të që ofrojnë shërbime të tilla në komunën e Novobërdës, ku do të mund të aplikojë vetëm ajo OJQ sepse është e vetmja e licencuar në Kosovë.	Për tri rastet e paraqitura në gjetje nuk ka pasur thirrje publike gjatë vitit 2024, ashtu siç kërkohet me Rregulloren MF. Nr 04/2017. Pavarësisht vendimeve të mëhershme apo specifikave të OJQ-ve, mungesa e procedurës së thirrjes publike përbën mospërputhje me parimet e transparencës dhe barazisë në ndarjen e fondeve publike. Arsyetimet e dhëna nuk e ndryshojnë gjendjen faktike të konstatuar - gjetja mbetet e pandryshuar.

Projekti “Ndhimë në shtëpi për të moshuarit” financohet gjithashtu në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi të drejtpërdrejtë nga viti 2017, ku kemi vendimin e asamblesë për të vazhduar financimin, ku është e rëndësishme të theksohet se ne e ndaluar financimin në vitin 2024. Sa i përket komentit lidhur me menaxheren e OJQ-së, ajo është e punësuar në arsim, por nuk është e punësuar në një organizatë joqeveritare, por është e regjistruar në atë organizatë si përfaqësuese ligjore, gjë që është një funksion që nuk nënkupton domosdoshmërisht punësim ose përfitim financiar. Sipas Ligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konflikteve të interesit në kryerjen e funksioneve publike, konfliktet e interesit që ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen e paanshme dhe objektive të detyrave publike. Ajo nuk merr vendime për financimin e OJQ-ve, as nuk ka ndonjë ndikim në proceset e ndarjes së fondeve. OJQ-ja ka nënshkruar një memorandum me komunën në kuadër institucional, në përputhje me procedurat. Menaxheri nuk nxjerr përfitim personal financiar nga kjo marrëdhënie. Fondet, nëse ekzistojnë, ndahen me vendim të kuvendit komunal dhe përmes një marrëdhënieje transparente. Ne besojmë se në përputhje me legjislacionin e lartpërmendur, roli i një përfaqësuesi ligjor në një OJQ nuk përbën konflikt interesi.

Pagesa ndaj punëtorëve të angazhuar për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike pa përcaktim të qartë të kompensimit	Sipas Aneksit të marrëveshjes ndërmjet komunës së Novobërdës dhe JKP "Ekologija", për angazhimin e punëtorëve sezonalë, ndërmarrja ka punësuar këta punëtorë për kryerjen e punëve të mirëmbajtjes dhe pastrimit të hapësirave publike, kompania ka angazhuar punëtorë sezonalë për një periudhë të caktuar. Sipas konkursit publik të cilin e kanë shpallur - kontratat janë nënshkruar me punëtorët ku specifikohet lartësia e pagave, e cila është e barabartë me pagat e punëtorëve, tashmë të punësuar në kompaninë JKP Ekologija për nevojat e komunës së Graçanicës. Sipas marrëveshjes bazë, ndërmarrja është përgjegjëse për përpilimin e orarit mujor të punës dhe është paraparë që angazhimi dhe kompensimi të ndryshojnë në përputhje me kohën dhe natyrën sezonale të punës. Prandaj, nuk ka qenë e mundur të konkretizohet shuma në aneksin e marrëveshjes. Sipas marrëveshjes bazë ndërmjet JKP Ekologija dhe komunës së Novobërdës, ndërmarrja është përgjegjëse për përpilimin e orarit mujor të punës dhe është paraparë që angazhimi dhe kompensimi të ndryshojnë në përputhje me kohën dhe natyrën sezonale të punës. Prandaj, kompensimi monetar (paga) është i ndryshueshëm në përputhje me kohën e kaluar në punë dhe angazhimin sezonal, dhe nuk mund të specifikohet në aneksin e marrëveshjes.	Mungesa e përcaktimit të qartë të kompensimit në marrëveshje apo në ndonjë aneks të saj paraqet mangësi të transparencës dhe kontrollit. Dokumentet e ofruara nuk përmbajnë baza të qarta për përllogaritjen e pagesave, ndërsa ndryshueshmëria sezonale nuk e përjashton nevojën për kritere të dokumentuara dhe të miratuara nga Komuna. Prandaj, e gjetura mbetet se pagesat janë ekzekutuar pa përcaktim të qartë të kompensimit.
Vonesat në pagesën e faturave	E kuptojmë plotësisht nenin 39 të Ligjit për Zbatimin e Buxhetit, por për shkak të politikave të Thesarit që përcakton fondet mujore të disponueshme, nuk kemi qenë në gjendje të paguajmë të gjitha faturat që janë pranuar në atë muaj për shkak të mungesës së mjeteve.	Komuna ka dhënë një arsyetim të cilin e kemi thënë edhe ne pse kanë ndodhur vonesat në pagesa. Kjo nuk e ndryshon të gjeturën dhe gjendja mbetet e pandryshuar.

Mos azhurnimi i kontratave të punës në bazë të ligjit për zyrtarët publik	Në përputhje me Ligjin për Nëpunësit Publikë nr. 08/L-197, komuna ka hartuar Rregulloren për organizim dhe sistematizim të vendeve të punës. Më 12.04.2024, janë pranuar format për aktet e emërimit dhe kontratat e punës. Mirëpo, për shkak të vonesës së miratimit të katalogut të vendeve të punës nga Qeveria e Kosovës, nuk kemi mundur të finalizojmë aktet dhe kontratat në harmoni me ligjet. Qeveria e Kosovës me vendimin nr. 08/226, më 23.10.2024, ka miratuar katalogun e vendeve të punës në shërbimin publik dhe ka shfuqizuar pikat 3 dhe 4 të vendimit nr. 04/128. Në bazë të kësaj, Komuna nuk ka mundur të nënshkruaj aktemërime dhe kontrata pa katalog të miratuar, sepse kjo do të ishte në kundërshtim me Ligjin mbi nëpunësit publikë. Theksojmë se vonesa në miratimin e katalogut nuk u shkaktua nga komuna e jonë, por nga institucionet kompetente në nivel qendror. Pas marrjes së katalogut, menjëherë filloi përditësimi i kontratës, përditësimi u bë gjatë gjithë procesit të auditimit, dhe procesi i përditësimit të kontratës në shërbimin civil është aktualisht i përfunduar. Më 28 mars 2025, klasifikimi i vendeve të punës u finalizua. Bazuar në provat e ofruara, ne vepruam në përputhje me kërkesat ligjore dhe nuk jemi përgjegjës për vonesat që ndodhën jashtë kompetencave tona. Përveç kësaj, asnjë komunë në Kosovë nuk e përfundoi këtë proces në kohë për shkak të vonesës së lartpërmendur, e cila ishte temë diskutimi në takimet me institucionet përkatëse.	Nga dëshmitë e pranuar gjatë procesit të auditimit, është konstatuar se kontratat e punës nuk kanë qenë të azhurnuara siç kërkohet me Ligjin nr. 08/L-197 për Nëpunësit Publikë. Arsyet e prezantuara nuk e ndryshojnë gjendjen faktike të konstatuar. Gjetja mbetet e pandryshuar.
--	--	---

Mbajtja e pozitive me ushtrues detyre përtej afateve ligjore	Ushtruesi i detyrës ka të drejtë të ushtrojë funksionin deri në 12 muaj brenda një viti kalendarik. Në rastin konkret, ky afat nuk është tejkaluar. Ushtruesi ka vazhduar deri në kthimin e punonjësës nga pushimi pa pagesë. Vendimi ka qenë në fuqi dhe nuk është parë e nevojshme të nxirret vendim i ri çdo 6 muaj, pasi ligji lejon vazhdimin deri në 12 muaj. Respektimi i afatit ligjor është prioriteti ynë dhe ne kemi vepruar në përputhje me këtë dispozitë ligjore.	Në një rast ndonëse janë ndërmarrë përpjekje për rekrutim, procedurat janë anuluar tri herë për shkak të mungesës së kandidatëve të interesuar. Ndërkohë, për pozitat tjera të mbuluara me ushtrues detyre, nuk janë ndërmarrë fare procedura për shpalljen e konkurseve, gjë që bie ndesh me kërkesat për konkurrencë të hapur dhe angazhim të rregullt të stafit drejtues. Gjetja mbetet e pandryshuar.
Mos përmbushja e kriterëve sipas thirrjes publike me rastin e përfitimit të subvencioneve	Pronësia mbi traktorin pa blerjes nuk është bartur ende në mënyrë noteriale, por ekziston një marrëveshje ndërmjet palëve për bartje në të ardhmen. Këtë dokument po ua dërgojmë me këtë rast.	Siç edhe është prezantuar tek gjetja, dëshmia e noterizuar për shfrytëzimin e traktorit është lëshuar pas datës së vlerësimit të aplikacioneve dhe vendimit të marrë nga Komisioni i vlerësimit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacioneve në dosje të aplikantit dokumenti i ofruar tashmë nuk ka qenë pjesë e aplikacionit. Gjendja mbetet e pandryshuar.
Inventarizim jo i plotë i pasurisë dhe mosfunksionalizimi i sistemit E-pasuria	Ne disa herë ishim në MAPL për të fituar qasje në sistem, kemi dërguar emaile, punonjës tonë në ministri, por ata janë kthyer gjithmonë pasi në ministri nuk kanë pasur përkthyes në gjuhën serbe.	Obligimi për vënien në funksion të sistemit E-pasuria është përgjegjësi e Komunës dhe arsyetimet e bëra nga Komuna nuk e ndryshojnë gjendjen e gjetjes. Komuna nuk ka ndërmarrë veprime të mjaftueshme për të vënë në funksion sistemin E-pasuria. Vonesat e vazhdueshme në këtë drejtim ndikojnë në transparencën dhe menaxhimin efektiv të pasurisë publike. Si rrjedhojë, gjetja mbetet e pandryshuar.



POTVRDNO PISMO

O saglasnosti sa nalazima Generalnog Revizora na Izveštaju revizije za 2024 godinu kao i za sprovođenje preporuka

Za: Nacionalnu Kancelariju Revizije:

Poštovani,

Preko ovog psima, potvrđujem da:

- sam primio Nacrt izveštaja Nacionalne Kancelarije Revizije o Reviziji Finansijskih Izveštaja Opštine **Novo Brdo**, za godinu završno sa 31 decembrom 2024. (u daljem tekstu "Izveštaj");
- ne slažem se / delimično se slažem sa nalazima i preporukama,

Pitanje B1 - Pogresna klasifikacija troskova u ekonomske kategorije

Izvršili smo uplatu za NVO vatrogasaca dobrovoljaca iz kategorije subvencije i transferi, jer je to NVO sektor, gde smo u medjuvremenu imali javni poziv i gde smo nastavili finansiranje preko javnog poziva.

Sto se tice izvršenja iz trezora mi tu nemamo ingerencije da uticemo na trezor prilikom isplate iz kolektivnog ugovora, gde i mi smatramo ako su troskovi napravljeni u plate i dnevnice da budu i tu pokriveni, da nam ne uzimaju sredstva u drugim ekonomskim kategorijama gde vec imamo odredjene planove za fiskalnu godinu.

Pitanje A3 - Nedostatak evidencija o prisustvu na poslu

Sto se tice radnika u obrazovanju, nastavno osoblje koristi elektronske dnevnik u koje ne mozemo imati uvid, jer skole rade po kurikulumu Republike Srbije. Dnevnik na Kosovu ne postoje na srpskom jeziku, zbog toga koristimo mesecne izvestaje direktora skola kao dokaz o prisustvu nastavnog osoblja na poslu.

Za radnike u Administraciji, pored izjave direktora da su bili prisutni na poslu, postoje i drugi dokazi kao sto su izvestaji o radu, zahtevi, odluke, zapisnici i slicno. Elektronski sistem je relativno nov i do ovakvih situacija je doslo zbog prilagodjavanja radnika na elektronsku evidenciju, koja ce u buducem periodu biti kompletna.

Pitanje A4, Ugovaranje i isplate u obliku avansa krseci Zakon o Javnim nabavkama i zakon o budzetu

Prema potpisanom sporazumu broj 02/2100 od dana 12.12.2024 sa NVO Zenski Inkluzivni Centar, glasi da je projekat finansiran od strane UN misije na Kosovu, opstina samo participira u tom projektu, gde je NVO Zenski Inkluzivni Centar aplikant u tom projektu UN misije na Kosovu. Sredstva nisu isplacena iz ekonomskog koda AVANS, vec iz participacije projekta, jer je to samo participiranje u projektu. Datum odobravanja projekta i potpisivanja sporazuma je bio pri kraju fiskalne godine i zato nije moglo biti isplaceno i koda avansa. Javna nabavka nije mogla biti izvršena samo za svoj deo sredstava, zato sto smo je opstina participirala manjim delom u projektu u odnosu na glavnog finansijera projekta. Ukoliko bismo mi radili javnu nabavku za nas deo u iznosu od 14 000 evra, a NVO Zenski Inkluzivni Centar za deo 20 000 USD, onda bi dve firme radile jedan posao i onda bi i tu bili u problemu sa duplim finansiranjem revitalizacije prostora za rad CEC Novo Brdo. Zbog toga je celokupnu tendersku proceduru radila NVO Zenski Inkluzivni Centar, projekat je u toku, predsednik je odlukom formirao nadzorni organ koji prati tok realizacije projekta, kao i odlukom imenovao kontakt osobu za koordinaciju implementacije projekta, gde cemo na kraju realizacije projekta izvestiti reviziju celokupnom dokumentacijom.

Pitanje A5, Isplata radnicima angazovanim na odrzavanju i ciscenju javnih prostora bez jasnog odredjivanja naknade.

Prema Aneksu sporazuma izmedju opstine Novo Brdo i preduzeca JKP Ekologija, da angazuje sezonske radnike za obavljanje poslova odrzavanja i ciscenje javnih površina, preduzece je angazovalo sezonske radnike na odredjeni period. Prema javnom konkursu koji su objavili - ugovori su potpisani sa radnicima gde je naveden iznos zarade koji je u visini plata radnika, vec radno angazovanih u preduzecu JKP Ekologija za potrebe opstine Gracanica. Prema osnovnom sporazumu izmedju JKP Ekologija i opstine Novo Brdo, odgovornost preduzeca je sastavljanje mesecnog radnog vremena za pruzanje usluga i predvidjeno je da se angazovanje, radno vreme i raspored moze menjati prema potrebama. Samim tim i promena novcane naknade (plate) je peomenljiva u skladu sa vremenom provedenom na radu i sezonskim angazovanjem, te se nije mogla konkretizovati u aneksu sporazuma.

Pitanje A6 – Kasnjenje u isplati faktura

U potpunosti razumemo clan 39 ZUJFO, ali pored politike trezora da mi na mesecnom nivou raspolazeno odredjenim sredstvima, mi nismo u mogucnosti da sve fakture pristigle u datom mesecu isplatimo zbog nedostatka sredstava u tom mesecu.

Pitanje B1 – Pogresna klasifikacija troskova u ekonomske kategorije

Izvršili smo uplatu za NVO vatrogasaca dobrovoljaca iz kategorije subvencije i transferi, jer je to NVO sektor, u medjuvremenu smo imali javni poziv i nastavljeno je finansiranje putem javnog poziva.

Sto se tice izvršenja iz trezora mi tu nemamo ingerencije da uticemo na trezor prilikom isplate iz kolektivnog ugovora, gde i mi smatramo ako su troškovi napravljeni u plate i dnevnice da budu i tu pokriveni, da nam ne uzimaju sredstva u drugim ekonomskim kategorijama gde vec imamo odredjene planove za fiskalnu godinu.

Pitanje B2- Finansijska podrška za NVO van postupaka javnog poziva.

Sto se tice finansiranja NVO Vatrogasaca dobrovoljaca- raspisan je javni poziv na osnovu nalaza Vasih kolega iz 2023. godine, tako da je to finansiranje nastavljeno na osnovu javnog poziva. Finansiranje NVO ZEC je pokrenuto na osnovu direktnog sporazuma sa NVO iz 2017.godine i odobreno odlukom nase skupstine o finansiranju, jer je funkcija NVO ZEC specifična i jedina sa licencom za zastitu zena od nasilja u porodici za sprsku zajednicu na Kosovu, medjutim u skorijem periodu opština ce raspisati javni poziv za sve NVO sa ulogom zastite zena, na teritoriji opštine Novo Brdo, na koji ce se javiti samo ta NVO jer je jedina sa licencom na Kosovu.

Projekat Gerontodomacija i pomoc Nega u kuci je isto finansiran na osnovu direktnog sporazuma o saradnji iz 2017 godine, gde imamo odluku skupstine o nastavku finansiranja, gde je vazno napomenuti da smo prestali sa finansiranjem u 2024. godini. Povodom vasesg komentara za rukovodilaca NVO, ona je zaposljena u prosveti, ali nije zaposlena u nevladinoj organizaciji, vec je u toj organizaciji registrovana kao zakonski zastupnik, sto je funkcija koja ne podrazumeva nuzno radni odnos niti finansijsku korist. Prema Zakonu br. 06/L-011 o sprecavanju sukoba interesa u obavljanju javne funkcije, sukob interesa koji utice ili moze uticati na nepristrasno i objektivno obavljanje javne duznosti. Ona ne donosi odluke o finansiranju NVO, niti ima uticaj na procese dodele sredstava. NVO ima potpisan memorandum sa opštinom u institucionalnom okviru, u skladu sa procedurama. Rukovodilac ne ostvaruje licnu finansijsku korist iz tog odnosa. Sredstva ukoliko postoje, dodeljena su po skupstinskoj odluci i kroz transparentan odnos. Smatramo da u skladu sa navedenim zakonodavstvom, uloga zakonskog zastupnika u NVO, ne predstavlja sukob interesa.

Pitanje A7 - Ne ažuriranje ugovora o radu za javne službenike u skladu sa zakonom

U skladu sa Zakonom o javnim službenicima br. 08/L-197, Opština je izradila Pravilnik o organizaciji i sistematizaciji radnih mesta. Dana 12.04.2024. godine, od Odeljenja za upravljanje javnim službenicima kancelarija kadrovske sluzbe je primila obrasce (forme) za akte o imenovanju i ugovore o radu. Medjutim, zbog kašnjenja u usvajanju kataloga radnih mesta od strane Vlade Kosova, nismo bili u mogućnosti da završimo imenovanja i ugovore u skladu sa zakonom.

Vlada Kosova je Odlukom br. 08/226, od 23.10.2024. godine, usvojila Katalog radnih mesta u državnoj službi i stavila van snage tačke 3 i 4 Odluke br. 04/128. Na osnovu toga, Opština nije mogla da potpiše akte o imenovanju i ugovore bez usvojenog kataloga, jer bi to bilo u suprotnosti sa Zakonom o Javnim službenicima. Napominjemo da kašnjenje u usvajanju kataloga nije prouzrokovano od strane naše opštine, već od strane nadležnih institucija na centralnom nivou.

Nakon prijema kataloga, odmah je započeto sa ažuriranjem ugovora, azuriranje je radjeno I to kom procesa trajanja revizije i trenutno je završen process azuriranja ugovora u državnoj službi.

Dana 28.03.2025. godine izvršena je finalizacija klasifikacije radnih mesta. Na osnovu dostavljenih dokaza, postupili smo u skladu sa zakonskim zahtevima i ne snosimo odgovornost za kašnjenja koja su nastala van naših nadležnosti. Pored toga, nijedna opština na Kosovu nije završila ovaj proces na vreme zbog pomenutog kašnjenja, što je bila tema diskusije na sastancima sa relevantnim institucijama.

Pitanje A8, koje se odnosi na vršenje dužnosti na osnovu imenovanja vršioca dužnosti:

Vršilac dužnosti ima pravo da obavlja ovu funkciju do 12 meseci u okviru jedne kalendarske godine. U konkretnom slučaju, ovaj zakonski rok nije prekoračen, jer je vršilac dužnosti nastavio mandat do povratka zaposlene sa neplaćenog odsustva. Odluka je bila na snazi tokom ovog perioda i nije se smatralo potrebnim da se donosi nova odluka na svakih 6 meseci, jer zakon dozvoljava produženje mandata do 12 meseci.

Poštovanje zakonskog roka je naš prioritet i postupili smo u skladu sa ovom zakonskom odredbom.

Pitanje A9, Neispunjavanje kriterijuma prema javnom pozivu prilikom dobijanja subvencija.

Vlasništvo traktora nakon kupovine nije preneto kod notara ali oni su medjusobno potpisali dokument do konacnog prenosa vlasništva kod notara na koji vi niste hteli da imate uvid ali ga mi ovim putem saljemo.

Pitanje C1- Nepotpun popis imovine i ne funkcionalizacija sistema e-imovina

Mi smo vec nekoliko puta isli u MALS, da dobijemo pristup sistemu, slali mejlove, nase radnike u ministarstvu ali su se oni uvek vracali jer u ministarstvu nisu imali prevodioca na srpskom jeziku.

; i da ću

- u roku od 30 dana od prijema Završnog izveštaja, dostaviti akcioni plan za sprovođenje preporuka, koji će uključiti vremenske rokove i osoblje koje je odgovorno za njihovo sprovođenje.

g. Sasa Milosevic

Gradonačelnik Opštine,

Datum: 13.06.2025, Novo Brdo

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁹ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet¹⁰, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Kontratat e lidhura mes OJQ dhe operatorëve ekonomik.
- ⁶ 21 në sektorin e arsimit, një (1) në shëndetësi dhe dy (2) në administratën komunale.
- ⁷ [1] Pjesëmarrja e komunës 70 % dhe e fermerit 30%
- ⁸ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁹ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ¹⁰ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.